

The Words of Christ and the Holy Ghost Will Lead Us to the Truth

By Elder Takashi Wada
Of the Seventy

Fjalët e Krishtit dhe Fryma e Shenjtë do të na Prijnë tek e Vërteta

Nga Plaku Takashi Uada,
i Të Shtatëdhjetëve

October 2024 general conference

Knowing this incredible plan will help us know we are children of God and we can become like Him.

God is our Father in Heaven. We are His spirit-children, and we are created after His image. Therefore, each of us, as a child of God, has a divine potential to become like Him.

We lived with Him as spirits before we came to this earth. Heavenly Father, as our spirit parent, loves us, wants the best for us, and prepared a plan for us to receive His greatest blessings, which are immortality and eternal life. According to the plan, we, as spirit children, would be given agency to choose His plan. By coming to the earth, we would leave God's presence, forget our premortal life, receive bodies of flesh and bones, gain our own experience, and develop faith. With our bodies of flesh and bones, as natural men we would succumb to temptation, become unclean and distant from God, and not be able to return to His holy presence. Because of Heavenly Father's infinite love for us, He sent His Firstborn Son, Jesus Christ, to be our Savior. Through His sacrifice, the Atonement, Jesus Christ made it possible for us to be redeemed from our sins and be resurrected and receive eternal life.

I am extremely grateful for these glorious truths—what we call the Father's plan of salvation, His plan of mercy, or His great plan of happiness. Learning these important truths has helped me know my true identity and the great

Njohuria për këtë plan të jashtëzakonshëm do të na ndihmojë të dimë që jemi fëmijë të Perëndisë dhe mund të bëhemi si Ai.

Perëndia është Ati ynë në Qiell. Ne jemi fëmijët e Tij shpirtërorë dhe jemi krijuar sipas shëmbëlltyrës së Tij. Prandaj, secili prej nesh, si fëmijë i Perëndisë, ka një potencial hyjnor për t'u bërë si Ai.

Ne jetuam me Të si shpirta përpara se të vinim në këtë tokë. Ati Qiellor, si prindi ynë shpirtëror, na do, dëshiron më të mirën për ne dhe përgatiti një plan që ne të marrim bekimet e Tij më të mëdha, të cilat janë pavdekësia dhe jeta e përjetshme. Sipas planit, neve, si fëmijë shpirtërorë, do të na jepej liria e zgjedhjes për ta zgjedhur planin e Tij. Duke ardhur në tokë, ne do të largoheshim nga prania e Perëndisë, do ta harronim jetën para lindjes, do të merrnim trupa prej mishi e kockash, do të fitonim përvojë vetjake dhe do të zhvillonim besimin. Me trupin prej mishi e kockash, si njerëz të natyrshëm, do t'i nënshtroheshim tundimit, të bëheshim të papastër e të largët nga Perëndia dhe nuk do të ishim në gjendje të ktheheshim në praninë e Tij të shenjtë. Prej dashurisë së pafundme të Atit Qiellor për ne, Ai dërgoi Birin e Tij të Parëlin-dur, Jezu Krishtin, që të ishte Shpëtimtari ynë. Nëpërmjet flijimit të Tij, Shlyerjes, Jezu Krish-ti bëri të mundur që ne të shëlboheshim nga mëkatet dhe të ringjallehim e të merrnim jetën e përjetshme.

Jam tejet mirënjohës për këto të vërteta të lavdishme, atë që e quajmë planin e Atit për shpëtimin, planin e Tij të mëshirës ose planin e Tij të madh për lumturinë. Të mësuarit e këtyre të vërtetave të rëndësishme më ka ndihmuar ta

blessings of exaltation and eternal life God has prepared for us. The prophet Nephi taught us the way: “Wherefore, ... feast upon the words of Christ; for behold, the words of Christ will tell you all things what ye should do.” He added, “If ye will enter in by the way, and receive the Holy Ghost, it will show unto you all things what ye should do.” Today I would like to share how the words of Christ and the Holy Ghost helped me find these important peace-giving truths in my teenage years.

The Words of Christ Will Tell You All Things What You Should Do

Just like Nephi stated in the opening verse of the book of 1 Nephi, I was also “born of goodly parents.” I grew up in Nagano, Japan, in a home where honesty, diligence, and humility were strongly encouraged and conformity to the old customs was strictly followed. My father was a very religious man. I watched him praying in front of the Shinto and Buddhist altars every morning and every night. Even though I had no idea whom he was praying to and what he was praying for, I believed some sort of unseen power or God would be “mighty to save” or help us if we prayed sincerely.

Like other teenagers, I experienced many hardships. I struggled, thinking that life was unfair and had lots of ups and downs. I felt lost, not having a sense of direction in my life. Life seemed so fleeting because it would end when I died. Life without knowing the plan of salvation was confusing.

Not long after I started to learn English in junior high school, all the students in our school received a copy of the New Testament. Though we had barely begun our study of English, our teacher told us we should study English by reading it. I opened it and reviewed its contents. The words in the New Testament were extremely difficult for me. The words in Japanese were equally difficult. However, I was drawn to a list of statements and questions of the soul that had been included just before the biblical text in this Gideon Bible—questions about feeling lonely, lacking confidence, being confused, facing life’s trials, and so on. Each item on the list was followed by a reference to verses and pages in the

di identitetin tim të vërtetë dhe bekimet e mëdha të ekzaltimit dhe jetës së përjetshme që Perëndia ka përgatitur për ne. Profeti Nefi na e mësoi mënyrën: “Prandaj, ... ushqehuni me bollëk me fjalët e Krishtit; pasi, vini re, fjalët e Krishtit do t’ju tregojnë të gjitha gjërat që ju duhet të bëni”. Ai shtoi: “Në qoftë se ju do të hyni nëpërmjet udhës dhe do të merrni Frymën e Shenjtë, ai do t’ju tregojë të gjitha gjërat që duhet të bëni”. Sot, do të doja të tregoja se si më kanë ndihmuar fjalët e Krishtit dhe Fryma e Shenjtë që t’i gjej këto të vërteta paqedhënëse të rëndësishme në vitet e adoleshencës.

Fjalët e Krishtit do t’ju Tregojnë të Gjitha Gjërat që Ju Duhet të Bëni

Sikurse e pohoi Nefi në vargun që hap librin të 1 Nephi, edhe unë u “lind[a] nga prindër të mirë”. U rrita në Nagano të Japonisë, në një shtëpi ku ndershmëria, zelli dhe përlësia nxiteshin fuqimisht dhe ku zbatoheshin në mënyrë të prerë bindja ndaj zakoneve të vjetra. Im atë ishte shumë fetar. E shihja të lutej përpara altarëve të besimit shinto dhe budist çdo mëngjes dhe çdo natë. Megjithatë nuk e kisha farë idenë se kujt po i lutej dhe për çfarë po lutej, besoja se një lloj fuqie e padukshme ose Perëndia do të ishte “i fuqishëm të [na] shpëto[nte]” ose të na ndihmonte po të luteshim sinqerisht.

Si adoleshentët e tjerë, përjetova shumë vështirësi. Mundohesha nga mendimi se jeta ishte e padrejtë dhe kishte shumë ulje-ngritje. Ndiheja i humbur, pa pasur një ndjesi orientimi në jetë. Jeta dukej aq fluturake sepse do të mbaronte kur të vdisja. Jeta, pa e ditur planin e shpëtimit, qe pështjelluese.

Jo shumë kohë pasi nisa të mësoja gjuhën angleze në nëntëvjeçare, të gjithë nxënësit e shkollës sonë morën një kopje të Dhiatës së Re. Ndonëse sapo e kishim filluar studimin e anglishtes, mësuja na tha se duhej ta studionim gjuhën angleze duke e lexuar atë. E hapa dhe shqyrtova përmbajtjen e saj. Fjalët në Dhiatën e Re qenë tejet të vështira për mua. Fjalët në gjuhën japoneze qenë po aq të vështira. Sidoqoftë, më tërhoqi një listë thëniesh dhe pyetjesh të shpirtit që qe përfshirë pikërisht para tekstit biblik në Biblën e organizatës Gideon, pyetje rreth të ndierit të vetmuar, mungesës së vetëbesimit, të qenit të pështjelluar, përballimit me sprovat e jetës e kështu me radhë. Secili zë në listë ndiqej nga një referencë për te

New Testament. I was especially drawn to the statement “When you are weary.” The reference led me to open Matthew 11:28–30, in which Jesus said to His disciples:

“Come unto me, all ye that labour and are heavy laden, and I will give you rest.

“Take my yoke upon you, and learn of me; for I am meek and lowly in heart: and ye shall find rest unto your souls.

“For my yoke is easy, and my burden is light.”

This was the first time I remember reading the words of Jesus Christ. Though I did not understand all the words He said, His words comforted me, lifted my soul, and gave me hope. The more I read His words, the more I felt like I should try the virtue of His words. I had never felt like I felt that day. I felt I was loved. I felt that Jesus Christ was someone I knew.

As I continued studying, I felt as though He were speaking directly to me when He said, “Blessed are they which do hunger and thirst after righteousness: for they shall be filled.”

His words filled my heart, even though I could not describe my feelings well at that time. Although Jesus Christ lived many centuries ago in a land unfamiliar to me, I thought I could trust His words with all my heart. I hoped someday in the future I might learn more about Jesus Christ.

The Holy Ghost Will Show You All Things What You Should Do

That someday came only a few years later. I met very dedicated, young, full-time missionaries of The Church of Jesus Christ of Latter-day Saints. And I soon met a small group of kind and joyful Latter-day Saints striving to follow Jesus Christ. Despite it taking me a while to fully trust them, I came to see in the restored gospel what I yearned for when I studied the New Testament—the words of Jesus Christ and the hope and peace that come from them.

A particularly sacred experience was when the missionaries taught me to pray. I learned that we should address God by name. When we pray, we should speak from our hearts, express our gratitude, and share our hopes and desires. Once we have said all that we want to say, we end our

disa vargje dhe faqe në Dhiatën e Re. Më tërhoqi veçanërisht thënia: “Kur të jesh i/e rraskapitur”. Referenca më shtyu të hapja vargjet te Mateu 11:28–30, tek të cilat Jezusi u tha dishepujve:

“Ejani tek unë, o ju të gjithë të munduar dhe të rënduar, dhe unë do t’ju jap çlodhje.

Merrni mbi vete zgjedhën time dhe mësoni nga unë, sepse unë jam zemërbutë dhe i përlurur nga zemra; dhe ju do të gjeni prehje për shpirtat tuaj.

Sepse zgjedha ime është e ëmbël dhe barra ime është e lehtë!”

Kjo ishte hera e parë që mbaj mend t’i kem lexuar fjalët e Jezu Krishtit. Megjithëse nuk i kuptoja të gjitha fjalët e thëna prej Tij, fjalët e Tij më ngushëlluan, më lartësuan shpirtërisht dhe më dhanë shpresë. Sa më shumë i lexoja fjalët e Tij, aq më shumë ndieja se duhej ta provoja virtytin e fjalëve të Tij. Nuk isha ndier kurrë si atë ditë. Ndjeva se më donte. Ndjeva se Jezu Krishti ishte dikush që njihja.

Teksa vazhdova studimin, u ndjeva sikur Ai po më fliste drejtpërsëdrejti mua kur tha: “Lum ata që janë të uritur dhe të etur për drejtësi, sepse ata do të ngopen”.

Fjalët e Tij ma mbushën zemrën edhe pse nuk mund t’i përshkruaja mirë ndjenjat në atë kohë. Megjithëse Jezu Krishti jetoi shumë shekuj më parë, në një vend të panjohur për mua, mendova se mund t’u mirëbesoja fjalëve të Tij me gjithë zemër. Shpresoja që një ditë në të ardhmen, të mund të mësoja më shumë rreth Jezu Krishtit.

Fryma e Shenjtë do t’ju Tregojë të Gjitha Gjërat që Ju Duhet të Bëni

Ajo një ditë erdhi vetëm pak vite më vonë. Njoha misionarët kohëplotë të rinj në moshë, shumë të përkushtuar të Kishës së Jezu Krishtit të Shenjtorëve të Ditëve të Mëvonshme. Shpejt njoha një grup të vogël shenjtorësh dashamirës e buzagaz të ditëve të mëvonshme, që përpiqeshin fort ta ndiqnin Jezu Krishtin. Pavarësisht se m’u desh ca kohë që t’u mirëbesoja plotësisht, arrita të shihja në ungjillin e rivendosur atë që ma donte shpirti kur studiova Dhiatën e Re – fjalët e Jezu Krishtit dhe shpresën e paqen që vijnë prej tyre.

Një përvojë veçanërisht e shenjtë që kur misionarët më mësuat të lutesha. Mësova se duhej t’i drejtoheshim Perëndisë në emër. Kur lutemi, duhet të flasim nga zemra, të shprehim mirënjohjen tonë dhe të tregojmë shpresat e dëshirat tona. Pasi të kemi thënë gjithçka që duam të

prayer by saying, “In the name of Jesus Christ, amen.” We do this because Jesus commanded us to pray in His name. Praying to Heavenly Father helped me know who He is and my relationship with Him—that I was His beloved spirit son. I learned that because Heavenly Father knows and loves me, He would speak to me personally, uniquely, and in ways I would understand through the Holy Ghost.

There was a time when I really could not recognize the Holy Ghost. I misunderstood, thinking that all I had to do was follow the steps of prayer and something dramatic would happen. One day, during a lesson with the missionaries, I stepped out of the lesson to take a break. I was still confused about what I should do with my life if the restored gospel of Jesus Christ really was true.

As I was about to return to the room where the missionaries were waiting, I heard the voice of one of the missionaries. I heard my name. Instead of opening the door, I listened to the voice on the other side of the door. I was stunned. They were simply praying to Heavenly Father. The one saying the prayer was pleading to God that He would hear my prayer. Though his Japanese was not fluent, hearing his sincere prayer softened my heart. I wondered why they cared about me so much. Then I realized that their prayer in my behalf was a reflection of Heavenly Father and the Savior’s love for me. That love gave me hope, and afterward I did ask God in faith and with real intent. When I did, I felt a joyful and peaceful feeling that I was indeed a child of God and that I had a divine potential and destiny. The plan of salvation sank deep into my heart.

President Russell M. Nelson has said, “The way you think about who you ... are affects ... every decision you will ever make.” It is so true for me. The decision to follow the Savior Jesus Christ by being baptized and receiving the gift of the Holy Ghost blessed my life more than I ever imagined. As we enter into the baptismal covenant with God, we promise that we are willing to take upon ourselves the name of Jesus Christ, keep the commandments of God, and serve Him for the remainder of our lives. Our Heavenly Father, in turn, promises us that we can always have His Spirit to be with us—the continued guidance from the Holy Ghost.

themi, e mbyllem lutjen duke thënë: “Në emrin e Jezu Krishtit, amen”. Ne e bëjmë këtë sepse Jezusi na urdhëroi të lutemi në emrin e Tij. Lutjet ndaj Atit Qiellor më ndihmuan ta dija se kush ishte Ai dhe të dija marrëdhënien time me Të – që isha biri i Tij i dashur shpirtëror. Mësova se, ngaqë Ati Qiellor më njeh e më do, Ai do të më fliste në mënyrë vetjake e të pashoqe dhe në mënyra që do t’i kuptoja vetëm nëpërmjet Frymës së Shenjtë.

Pati një periudhë kur nuk mundesha vërtet ta dalloja Frymën e Shenjtë. E keqkuptoja duke menduar se gjithë çfarë duhej të bëja, ishte të ndiqja hapat e lutjes dhe do të ndodhte diçka dramatike. Një ditë, gjatë një mësimi me misionarët, dola nga mësimi për të bërë një pushim. Isha ende i pështjelluar në lidhje me atë që duhej të bëja me jetën time nëse ungjilli i rivendosur i Jezu Krishtit ishte njëmend i vërtetë.

Ndërsa po kthehesha në dhomën ku po prisnin misionarët, dëgjova zërin e njërit prej misionarëve. Dëgjova emrin tim. Në vend që ta hapja derën, dëgjova zërin nga ana tjetër e derës. U shtanga. Ata thjesht po i luteshin Atit Qiellor. Ai që po bënte lutjen, po i përgjerohej Perëndisë që të dëgjonte lutjen time. Ndonëse nuk e fliste rrjedhshëm gjuhën japoneze, të dëgjuarit e lutjes së tij të sinqertë ma zbuti zemrën. Vrisja mendjen pse ata interesoheshin aq shumë për mua. Më pas e kuptova se lutja e tyre në emrin tim që një pasqyrim i dashurisë së Atit Qiellor dhe Shpëtimtarit kundrejt meje. Ajo dashuri më dha shpresë dhe, paskëta, e pyeta vërtet Perëndinë me besim dhe qëllim të vërtetë. Kur e bëra, pata një ndjesi të gëzueshme e paqësore që isha njëmend një fëmijë i Perëndisë dhe se kisha një potencial e vendmbërritje hyjnore. Plani i shpëtimit m’u zhyt thellë në zemër.

Presidenti Rasëll M. Nelson ka thënë: “Mënyra se si mendoni rreth asaj se kush jeni vërtet, ndikon ... në çdo vendim që do të merrni ndonjëherë”. Sa e vërtetë është kjo për mua! Vendimi për ta ndjekur Shpëtimtarin, Jezu Krishtin, duke u pagëzuar dhe duke marrë dhuratën e Frymës së Shenjtë ma bekoi jetën më shumë nga sa e kisha përfytyruar ndonjëherë. Ndërsa hyjmë në besëlidhjen e pagëzimit me Perëndinë, ne premtojmë se jemi të gatshëm të marrim mbi vete emrin e Jezu Krishtit, të zbatojmë urdhërimet e Perëndisë dhe t’i shërbejmë Atij gjatë gjithë pjesës së mbetur të jetës. Ati ynë Qiellor, në këmbim, na premtonte se mund ta kemi gjithmonë

I invite you to have faith in the message Nephi taught us—that the words of Christ and the Holy Ghost will direct you to “all things what [you] should do.” Everything! This is an incredible gift from God.

Brothers and sisters, I am grateful for our Heavenly Father’s plan of salvation. Because He loves us, He prepared the way to return to His presence through His Only Begotten Son, Jesus Christ. Knowing this incredible plan will help us know we are children of God and we can become like Him. I am grateful for this important truth. I bear you my witness that the words of Jesus Christ and the Holy Ghost will lead us to receive eternal life. I know these things are true. In the sacred name of Jesus Christ, amen.

Shpirtin e Tij me vete, udhërrëfimin e vazhdueshëm nga Fryma e Shenjtë.

Ju ftoj të keni besim te mesazhi që na mësoi Nefi se fjalët e Krishtit dhe Fryma e Shenjtë do t’ju drejtojnë tek “të gjitha gjërat që duhet të bëni”. Të gjitha! Kjo është një dhuratë e jashtëzakonshme nga Perëndia.

Vëllezër e motra, jam mirënjohës për planin e Atit tonë Qiellor për shpëtimin. Ngaqë na do, Ai përgatiti udhën që të kthehemi në praninë e Tij nëpërmjet Birit të Tij të Vetëmlindur, Jezu Krishtit. Njohuria për këtë plan të jashtëzakonshëm do të na ndihmojë të dimë që jemi fëmijë të Perëndisë dhe mund të bëhemi si Ai. Jam mirënjohës për këtë të vërtetë të rëndësishme. Ju jap dëshminë time se fjalët e Jezu Krishtit dhe Fryma e Shenjtë do të na prijnë për të marrë jetën e përjetshme. E di që këto gjëra janë të vërteta. Në emrin e shenjtë të Jezu Krishtit, amen.